



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë,14.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të OE-ik "GovEx" të datës 07.05.2021 të parashtruar lidhur me aktivitetin :**Sherbime te veçanta per angazhimin e permbarueseve privat,me nr. të Prok: 616 21 1718 221 nxjerr:**

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "GovEx" e datës 07.05.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sherbime te veçanta per angazhimin e permbarueseve privat,me nr. të Prok: 616 21 1718 221 kundër njoftimit për kontrate të AK-se , të datës 13.04.2021 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.
- 2.Autoriteti Kontraktues, ka vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 13.04.2021 dhe hapja është kryer me datën 11.05.2021
- 3.Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "GovEx" me datë 07.05.2021 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Sherbime te veçanta per angazhimin e permbarueseve privat,me nr. të Prok: 616 21 1718 221**

Autoriteti Kontraktues, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:
-Kërkesa është dorëzuar pas afatit të parapare me Rregullat për paarshtimin e ankesave dhe ka vazhduar aktivitetin e vet.Ua perkujtojmë kushtet e parapara në rregullat për parashtrim të ankesave,pikat 4 dhe 8 që i paraqesim në vijim:

I. PARAQITJA E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM PRANË AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 4

Periudha kohore për dorëzimin e një kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteti Kontraktues

4.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të paraqitet me shkrim dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

- a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë **(5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave.**
- b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej **pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.**
- c) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë **(5) ditëve nga data kur aktiviteti i prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.**

Neni 8 Vendimi i Autoritetit Kontraktues

8.1 Autoriteti kontraktues, **respektivisht Zytari Përgjegjës i Prokurimit**, mund, me anë të një vendimi:

8.1.1 **të refuzojë** kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabazë;

- i. Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me vendimin **për shpërblim të një kontrate**, Autoriteti Kontraktues, për nënshkrim të kontratës, duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marr një vendim.
- ii. Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me **njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit**, Autoriteti Kontraktues do të vazhdojë me tutje me procedurën e prokurimit.

Pra kërkesa juaj është dërguar pas afatit të parapare ligjor dhe në harmoni me nenin 8.ii. Autoriteti Kontraktues ka vazhduar aktivitetin e vet.


Zytari përgjegjës i Prokurimit